

LEVIZALBANIA ORGANIZON: JAVËN E DEMOKRACISË VENDORE 7-11 MAJ 2018

Aktivizmi qytetar është guri i themelit për një demokraci funksionale dhe qeverisje vendore cilësore. Projekti LevizAlbania financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri" dhe "Co-Plan". Gjatë viteve të zbatimit projekti ka mbështetur mbi 130 nisma, objektivi të cilave ka qenë forcimi i demokracisë vendore dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve të Shqipërisë. #JavaDemokracisëVendore2018 është momenti për të ballafaquar arritjet e projektit LevizAlbania dhe sfidat me të cilat aktorët e shoqërisë civile janë përballur përgjatë zbatimit të projekteve si dhe diskutuar mbi këto çështje me aktorët e ndryshimit dhe ata politikbërës. Aktivitetet gjithëpërfshirëse dhe të shtrira në të gjithë vendin do të synojnë të angazhojnë qytetarët, aktorët e shoqërisë civile, të zgjedhurit vendor dhe ata qëndror në forume dhe debate publike.

FORUMI "ADVOKACIA QYTETARE NË MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E MJEDISIT"

Aktiviteti shënon çeljen e siparit të Javës së Demokracisë Vendore 2018. Forum i nivelit të lartë ku do të diskutohen nismat e mbështetura nga LevizAlbania në fushën e mjedisit, me pjesëmarrjen e Ambasadorit të Zvicrës, Ministrin të Mjedisit & Turizmit, Konsorciumit të LA dhe Ekspertëve Ndërkombëtarë..

🕒 09:30 - 14:00 📍 HOTEL THE PLAZA - SALLA "GERALDINA" Tiranë

E HËNË
7 MAJ

HISTORI SUKSESI - VIDEO DOKUMENTARI 2 I LEVIZALBANIA DHE PANEL DISKUTIMI

LevizAlbania do të paraqesë për herë të parë video-dokumentarin "Histori Suksesi" mbi nismat që kanë adresuar tematika të lidhura me demokracinë vendore dhe qeverisjen lokale kanë arritur të sjellin ndryshim në komunitet e përhira dhe të targetuara. Pas shfaqjes së dokumentarit ekspertët të shoqërisë civile, gazetarë dhe grantmarrës të LevizAlbania do të diskutojnë mbi nevojën për më shumë aktivizëm qytetar në funksion të demokracisë vendore.

🕒 18:00 - 20:00 📍 OFFICINA (tek Harry Fultz), Tiranë

RAPORTI I SITUATËS SË FINANCAVE VENDORE NGA CO-PLAN

Co-Plan si pjesë e konsorciumit të LevizAlbania do të prezantojë për publikun raportin e situatës së financave vendore realizuar në kuadër të projektit të platformës financatvendore.al që është financuar nga LevizAlbania përmes instrumentit mundësues strategjik.

🕒 10:30 - 13:30 📍 HOTEL ROGNER - ANTIGONEA 2, Tiranë

E MARTË
8 MAJ

TEATRI "NË DET TË HAPUR" & DEBAT I HAPUR PUBLIK

Pjesa teatrale rezultoi e suksesshme në paraqitjen për herë të parë në audiencën e kryeqytetit. Ajo rikthehet në qytetin e Durrësit dhe do të shoqërohet nga një diskutim i hapur për publikun me pjesëmarrjen e grantmarrësve të LevizAlbania, aktorëve të shoqërisë civile dhe të zgjedhurve vendorë.

🕒 13:00 - 15:00 📍 Durrës

TRYEZA E RRUMBULLAKËT "FUQIZIMI I PJESËMARRJES SË DREJTPËRDREJTË TË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE"

E drejta qytetare për referendume vendore. Një tryezë në përmbajtjen e së cilës do të jenë përfaqësuesit e SDC në Shqipëri, Konsorciumi i LA, anëtarët e Komisionit të Posatshtëm të Reformës Zgjedhore dhe grantmarrësit e LevizAlbania.

🕒 10.30 - 13.30 📍 HOTEL ROGNER - ANTIGONEA 2, Tiranë

E MËRKURË
9 MAJ

DEMOKRACIA LOKALE DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Ndërthurja e dy aktiviteteve të grantmarrësve të LA që zbatojnë projektet në rajonin e Korçës dhe që kanë në fokusin e tyre rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjen lokale. DemoArt dhe Teatri i Rrugës vijnë me një performancë të ndërthurur për të rritur vëmendjen qytetare ndaj të drejtës për të qenë pjesë e vendimarrjes. Aktiviteti do të pasohet nga ballafaqimi i qytetarëve me Kryetarin e Bashkisë së Korçës.

🕒 16:00 - 18:00 📍 MUZEU KOMBËTAR I ARSIMIT, Korçë

KAMPET E DEMOKRACISË VENDORE

Për të angazhuar sa më shumë të rinj në forcimin e demokracisë vendore, organizata "Partnerët e Shqipëri" si anëtare e Konsorciumit të projektit dhe me mbështetjen e LevizAlbania organizon "Kampet e Demokracisë Vendore". Të rinjtë që formohen në kapacitetet për të hartuar projekte dhe për tu angazhuar në fushën e shoqërisë civile.

🕒 Ora: 10:00 - 12:00 📍 VLORË

E ENJTE
10 MAJ

DEBAT PUBLIK MBI ÇËSHTJET SOCIALE NË BULQIZË

Një aktivitet i organizuar nga grantmarrësit e LevizAlbania që zbatojnë projekte në zonën e Bulqizës dhe që synon të ngrejë debatin publik për më shumë politika sociale në këtë bashki. Të rinj, aktorë të shoqërisë civile dhe të zgjedhur vendor të mbledhur në një aktivitet ndërgjegjësues dhe advokues.

🕒 11.00 - 14.00 📍 HOTEL BULQIZA, Bulqizë

PREZANTIMI I "PLATFORMËS VENDORE"

Për herë të parë do të prezantohet për publikun nismat e ndërmarrë nga "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", i cili përmes mbështetjes së LevizAlbania ka ndërtuar platformën multifunksionale që do të kthehet në portë udhërrëfyese për qytetarët që kërkojnë informacion mbi funksionimin e pushtetit vendor dhe do të fuqizojë gazetarinë vendore duke u kthyer në një ditare për më shumë lajme në nivel lokal. Në aktivitet do të marrin pjesë aktorë të shoqërisë civile, grantmarrës të LA, gazetarë të njohur dhe Konsorciumi i LA.

🕒 10.00 - 12.00 📍 QENDRA RINORE, Tiranë

E PREMTE
11 MAJ

AKTIVITETI PËRMBYLLËS I JAVËS: CEREMONIA E NDARJES SË ÇMIMEVE "AKTIVIZMI QYTETAR NË FUNKSION TË DEMOKRACISË VENDORE"

Dy ngjarje në një vend. Një event dedikuar të rinjve dhe aktivizimit të tyre për më shumë demokraci vendore dhe politika rinore prej të zgjedhurve vendore. Shpallja e fituesve të videokonkursit të LevizAlbania ku të rinjtë përmes videove do të adresojnë çështje dhe tematika të komunitetit që lidhen me shërbimet e njësive administrative dhe ceremonia e dhënies së "Certifikatave të Mirënjohjes" për grantmarrësit individ që kanë advokuar për të rinjtë përgjatë thirrjeve për aplikime.

🕒 18:30 - 20:30 📍 AKADEMIA E ARTEVE - BLACK BOX, Tiranë